



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

PËR

PROJEKT RREGULLOREN NR. X/2023 PËR PROCEDURËN DISIPLINORE TË TË PUNËSUARËVE NË ADMINISTRATËN GJYQËSORE

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktoj procedurat disiplinore për të punësuarit në administratën gjyqësore, përfshirë hetimin disiplinor, themelimin, përbërjen dhe përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit disiplinor, masat disiplinore, si dhe mjetet e lejuara ankimore për të punësuarit në administratën gjyqësore me rastin e shqiptimit të masave disiplinore.

Përmes kësaj draft rregullore synohet që dispozitat e saj të jenë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në administratën gjyqësore, duke përfshirë Sekretariatën,

Njësinë për Inspektim Gjyqësor dhe Gjykatat.

Përrjashtimisht kësaj, dispozitat e kësaj rregullore nuk do të zbatohen për të punësuarit për cilët Këshilli ka paraparë rregullim të tjetër të procedurës disiplinore.

Më tej, me këtë draft rregullore përcaktohen edhe parimet e procedurës disiplinore për të punësuarit në administratën gjyqësore, masat disiplinore, trajtimi dhe shqyrtimi i shkeljeve disiplinore nga zyra për disiplinim në kuadër të Njësisë, forma e ankesës, kompetencat e komisionit disiplinor, si dhe mbështetja administrative për këtë komision.

Tutje, rregullorja përcakton edhe parimet e procedurës disiplinore, personat kompetent për caktimin e masave disiplinore si dhe inicimi i procedurës disiplinore duke përfshirë paraqitjen e shkeljeve disiplinore, trajtimin e shkeljeve disiplinore, evidentimin dhe regjistrimin e ankesës (shkeljes), fillimin e procedurës disiplinore, seancën e Komisionit Disiplinor si dhe kompetencat e komisionit disiplinor

2. Arsyetimi i aktit normative

Arsyeja e hartimit të projekt Rregullore X/2023 për Procedurën Disiplinore të të Punësuarve në Administratën është për të krijuar procedura disiplinore efikase dhe efektive për të punësuarit në administratën gjyqësore, me qëllim të përcaktimit të një procedurë standarde të hetimin disiplinor dhe zhvillimit të fazave të procedurës disiplinore e cila ndryshon nga procedura disiplinore e aktuale, për të cilën është vërtetuar se ka ngecje si në aspektin e procedurës hetimore ashtu edhe në aspektin vendimmarrës.

Iniciativës për hartimin e kësaj projekt rregullore i ka paraprirë kërkesa e Këshillit për auditimin e procedurës disiplinore për të punësuarit në administratën gjyqësore, për të cilën është autorizuar Komisioni për Administrimin e Gjykatave.

Pas auditimit që i është bërë gjykatave të Republikës së Kosovës në lidhje me këtë çështje, KAGJ në raport ka dhënë disa rekomandime sipas të cilave Këshilli ka vendosur për hartimin e kësaj projekt rregullore me qëllim të përcaktimit të procedurave të qarta dhe standarde.

	<p>Ky akt është i nevojshëm për disa arsye të rëndësishme.</p> <p>Së pari, përcakton një zhvillim të procedurës disiplinore të standardizuar, efektive dhe efikase duke përcaktuar masat disiplinore të cilat mund të shqiptohen për të punësuarit në sistemin gjyqësor si dhe parashkrimin dhe shlyerjen e tyre nga dosja e personalit, pas kalimit të afateve të cilat janë përcaktuar edhe në rregullore.</p> <p>Së dyti, përcakton përgjegjësitë dhe krijon komisione të specializuara për shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe provave të cilat paraqiten kundër subjektit i cili është pjesë e hetimit disiplinor, si dhe procedurën e shqiptimit të masave disiplinore nga ana e Komisionit Disiplinor.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të Draftit të Rregullores X/2023 për Procedurën Disiplinor të të Punësuarve në Administratën Gjyqësore.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo</p>

	<p>sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 5 tetor 2023.</p>
4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>